



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

RAPORTI VJETOR

2021



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Shoqata Shqiptare e Bankave

Adresa zyrtare: Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower 9/3, Tiranë

Regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e Gjykatës nr.1153, datë 14 prill 1999

NIPT: K51626015F

Raporti Vjetor është një botim vjetor i përgatitur nga **Zyra Ekzekutive e AAB-së**, i disponueshëm në format digjital në faqen e internetit **www.aab.al**.

Informacioni në këtë Raport mund të përdoret vetëm për qëllime jo fitimprurëse, duke përmendur "Raporti Vjetor 2020", botuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB).

Ndalohet ndryshimi i pjesshëm apo i plotë i përmbajtjes së këtij Raporti.

Design & Layout: **FCB AFIRMA**

TABELA E PËRMBAJTJES _

1. MESAZH NGA KRYETARI	4
2. STRUKTURA ORGANIZATIVE	6
3. ANËTARËT E SHOQATËS	10
4. PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE TË AAB-SË NË VITIN 2021	11
5. FAKTE DHE SHIFRA PËR 2021 - SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI	13
6. SHTYLLAT KRYESORE TË AAB-SË	17
A) PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR DHE BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET	17
B) TRANSFORMIMI I SEKTORIT BANKAR	21
C) TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI I PUNONJËSVE TË BANKAVE	23
D) EDUKIMI FINANCIAR	29
E) KOMUNIKIMET, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MBROJTJA LIGJORE	32
7 KOMITETET TEKNIKE - PIKAT KRYESORE DHE ARRITJET	38
8. TAKIME TË TJERA	41
9. SHIFRA RRETH BANKAVE ANËTARE	45
10. PASQYRAT FINANCIARE	48

MESAZH NGA KRYETARI _

I nderuar Lexues,

Po të drejtohem me “ti” dhe jo me “ju”, jo për mungesë respekti, por nga dëshira për t’u ndjerë së bashku sa më afër njëri-tjetrit. Ajo që dëshiroj të theksoj në vijim është që na bashkon, na afron dhe na bën miqësor me njëri-tjetrin.

Viti 2021 erdhi pas një vit shumë të vështirë, sikurse ishte viti 2020, ose siç është quajtur, viti i Covid-19. Me shpresën dhe dëshirën që viti 2021 do të ishte më i mirë dhe më i shëndetshëm. Me gjithë vështirësitë e fillimit, në fakt, ndodhi që situata të zhvillohej për më mirë.

Industria bankare, si industri shërbimi ndaj njerëzve, bizneseve, privatit dhe shtetërorit, gjatë gjithë kohës ishte funksionale, pa ndërprerje, në gatishmëri ndaj kërkesave të tregut: kredi, depozita, veprime në tregun sekondar, këmbime valutore, transfertat, pagesa. Bankat u gjendën jo vetëm në degët fizike, por edhe online: me kompjuter dhe smartfone. Ju do të gjeni të dhëna për këto gjatë shfletimit të këtij botimi.

Për Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB) kjo situatë kërkonte angazhim që industria të mos vuante nga asnjë pengesë, qoftë logjistike, administrative apo ligjore. Ajo



vazhdoi misionin e vet në përmbushjen e objektivave të fushës. Më konkretisht:

- Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të statutit të ri, u themeluan komitetet teknike të reja. 7 komitete të reja dhe një i përkohshëm u bënë aktivë.
- Koordinimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave

dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e fiskalizimit si dhe ngritjen e regjistrit qendror të llogarive.

- Forcimi i marrëdhënieve me institucionet vendase dhe të huaja për bashkëpunim, si me Bankën e Shqipërisë, Delegacionin e Bashkimit Evropian, Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, si dhe takime me ministrat e qeverisë së dalë nga zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit.
- Edukimi financiar: në bashkëpunim me VISA u organizua një fushatë dy mujore për përdorimin e kartave; u organizua Konkursi i Parasë ku rreth 360 nxënës të klasave të 9-a morën pjesë; së bashku me EFSE, u bë i mundur planifikimi i përkthimit të librit "Hapat e parë në financë", një libër i dobishëm për këdo që kërkon të mësojë për financat personale dhe si literaturë për Konkursin e Parasë; në bashkëpunim me BSH dhe ANFE u punua për hartimin e projektit të strategjisë kombëtare të edukimit financiar; organizimi i një seminari për sigurinë kibernetike.
- 24 trajnime online me pjesëmarrjen e 340 punonjësve të industrisë bankare.

- AAB rriti prezencën nëpërmjet botimeve (Revistës Bankieri, Raportit Vjetor, dhe Raportit CRS), postimeve në rrjetet sociale, pjesëmarrjeve në median vizuale dhe publikime të të dhënave statistikore mbi ecurinë e sektorit bankar.

Në emër të Bordit Mbikëqyrës, falënderoj Zyrën Ekzekutive për mbarëvajtjen e punës dhe arritjen e objektivave, si dhe një falënderim të veçantë për të gjithë bashkëpunëtorët tanë, në veçanti anëtarët e komiteteve teknike, dhe të gjithë ata dashamirës dhe palë të interesuara për bashkëpunim me AAB!

Duke të falënderuar për vëmendjen e leximit të kësaj hyrje, të uroj lexim të këndshëm të faqeve në vijim!

Me respekt,

Bledar Shella

Kryetar, Shoqata Shqiptare e Bankave

& Drejtor i Përgjithshëm, Banka OTP Albania

STRUKTURA ORGANIZATIVE

ASAMBLEJA E ANËTARËVE¹

Asambleja është organi më i lartë vendimmarrës i AAB. Asambleja e Anëtarëve përbëhet nga:

- Kryetari;
- Anëtarët.

Kryetari i zgjedhur i Këshillit Mbikëqyrës është Kryetari i Asamblesë së Anëtarëve.²

Në fund të vitit 2021, Asambleja e Anëtarëve përbëhej nga 12 anëtarë.

Lista e mëposhtme përshkruan në detaje Bankat Anëtare të AAB-së dhe të Asamblesë së Anëtarëve:

Alpha Bank Albania / Georgios Papanastasiou, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Amerikane e Investimeve / Andi Ballta, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Kombëtare Tregtare / Seyhan Pencabligil, Drejtor i Përgjithshëm & Anëtar Bordi

Banka Credins / Maltin Korkuti, Drejtor i Përgjithshëm

First Investment Bank Albania / Bozhidar Todorov, Drejtor i Përgjithshëm

Intesa Sanpaolo Bank Albania / Alessandro D'Oria, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Procredit Albania / Mirsad Haliti, Anëtar i Bordit Drejtues

Banka Raiffeisen Albania / Christian Canacaris, Drejtor i Përgjithshëm

Banka OTP Albania / Bledar Shella, Drejtor i Përgjithshëm

Banka e Tiranës / Dritan Mustafa, Drejtor i Përgjithshëm

Union Bank / Flutura Veipi, Drejtor i Përgjithshëm

United Bank of Albania / Amel Kovačević, Drejtor i Përgjithshëm

¹ Dhjetor 2021

² Statuti i AAB-së për 2021

BORDI MBIKËQYRËS³

Bordi Mbiqëqyrës është organi më i lartë politikbërës, kontrollues dhe monitorues i Shoqatës. Bordi përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe kryesohet nga Kryetari i zgjedhur nga Asambleja ose, në rast të mungesës së tij, nga Zëvendëskryetari i zgjedhur, i cili mund të veprojë me të njëjtat kompetenca.

Tre prej të anëtarëve të Bordit zgjidhen nga përfaqësuesit e "Bankave Sistemike" (siç identifikohet nga BSH), dhe dy anëtarët e tjerë zgjidhen nga përfaqësuesit e bankave të tjera.

Anëtarët e Bordit Drejtues zgjidhen nga Asambleja e Anëtarëve për një mandat dy vjeçar.

Anëtarët e Bordit Mbiqëqyrës:



BLEDAR SHELLA

Kryetar
Drejtor i Përgjithshëm,
OTP Bank Albania



SEYHAN PENCABLILIGIL

Zëvendës Kryetar/e
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
dhe Anëtar Bordi i
Bankës Kombëtare Tregtare (BKT)



MALTIN KORKUTI

Anëtar
Drejtor i Përgjithshëm,
Banka Credins



DRITAN MUSTAFA

Anëtar
Drejtor i Përgjithshëm,
Banka e Tiranës



BOZHIDAR TODOROV

Anëtar
Drejtor i Përgjithshëm,
Fibank Albania

³ Statuti i AAB-së për 2021

ZYRA EKZEKUTIVE



SPIRO BRUMBULLI

AAB

Sekretar i

Përgjithshëm

Zyra Ekzekutive është organi mbështetës i Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe ndihmon Organet Drejtuese të AAB-së në zbatimin e detyrave të tyre funksionale. Ajo drejtohet dhe mbikëqyret drejtpërdrejt nga Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës.

Veprimtaritë e përditshme të Sekretariatit drejtohen nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Bordi Drejtues. Në përputhje me parashikimet e reja të Statutit të AAB-së, Sekretari i Përgjithshëm do të jetë përfaqësuesi ligjor i AAB.

Disa nga detyrat e Sekretariatit, të cilat menaxhohen nga Sekretari i Përgjithshëm, janë:

- » Të zbatojë vendimet e Asamblesë.
- » Të sigurojë që anëtarët të njoftohen për vendimet e Asamblesë së Anëtarëve dhe të Komitetit Ekzekutiv dhe që këto vendime të zbatohen në mënyrën e duhur.
- » Të përmbushë detyrat që i janë ngarkuar nga Komiteti Ekzekutiv.
- » Të përfaqësojë AAB-në në organet qeveritare, në gjykatë dhe me palë të treta, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- » Të vendosë në zbatim buxhetin vjetor dhe planin e biznesit.
- » Të hartojë informacione që do të publikohen nga Shoqata dhe t'ia përcjellë këto informacione Komitetit Drejtues.
- » Të mbikëqyrë llogaritë e AAB-së dhe të bashkëpunojë me audituesin.
- » Të hartojë dhe të nënshkruajë pasqyrat financiare të AAB-së.

Z. Spiro Brumbulli është aktualisht Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së.



KOMITETE TEKNIKE⁴

AAB themelon komitete teknike për të adresuar vazhdimisht çështjet më thelbësore brenda fushës së aktivitetit të saj. Komitetet Teknike, bazuar në organet kompetente profesionale, synuan t'i ofrojnë Këshillit Mbikëqyrës dhe Sekretarit të Përgjithshëm propozimet dhe përgjigjet e kërkuara në fushat e tyre specifike të përgjegjësive.⁵

Komitetet teknike ndihmëse themelohen nga Bordi Mbikëqyrës, në bazë të nevojave të Shoqatës.

Komitetet Teknike të përhershme fillestare

KOMITETI LIGJOR

Albina Hasanaj,

Kryetare,

Banka Kombëtare Tregtare (BKT)

KOMITETI I BURIMEVE NJERËZORE

Entela Zigori,

Kryetare,

Intesa Sanpaolo Bank Albania

KOMITETI I PËRPUTHSHMËRISË

Bertina Hajdini,

Kryetare,

OTP Bank Albania

KOMITETI I SIGURISË SË TIK DHE TI

Irena Rrushaj,

Kryetare,

Union Bank

KOMITETI I MENAXHIMI TË RISKUT

Elona Bollano,

Kryetare,

Banka Kombëtare Tregtare (BKT)

KOMITETI I AUDITIT

Ilir Rudi,

Kryetar,

Banka Amerikane e Investimeve

KOMITETI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT

Juela Ahmeti,

Kryetare,

Raiffeisen Bank Albania

Komitetet Teknike Ndhmëse

KOMITETI NDIHMËS I PAGESAVE, KARTAVE, DIGJITALIZIMIT DHE KANALEVE ALTERNATIVE

Irida Huta,

Kryetare,

OTP Bank Albania

⁴ E dhjetorit 2021

⁵ Statuti i AAB-së për 2021

ANËTARËSIMET _

AAB është anëtare, anëtare e asociuar ose partnere në organizatat e mëposhtme kombëtare dhe ndërkombëtare.



10

Anëtarësimet Ndërkombëtare:

- » Federata Evropiane e Bankave (EBF)
- » Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)
- » Forumi i Shoqatave të Bankave INTERBALKAN

Anëtarësimet Kombëtare

- » Këshilli Ekonomik Kombëtar
- » Këshilli Tatimor
- » Këshilli Ekonomik i Bashkisë së Tiranës
- » ICC Albania
- » Komiteti i Sistemit Kombëtar të Pagesave

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE TË AAB-SË NË VITIN 2021



2021 vijoi të ishte një vit i pazakontë nën efektet e pandemisë globale të COVID-19, i karakterizuar nga më pak kufizime në krahasim me vitin 2020, por përsëri jo normal siç ishte përpara shkurtit 2020. AAB u fokusua në punën e bazuar në shkresa fizike, komunikimin elektronik, trajnimet në internet dhe takimet e organizuara në variant webinar-sh.

- » Asambleja e Anëtarëve ka organizuar 3 mbledhje, ndërsa Këshilli Mbikëqyrës ka mbajtur 5 mbledhje të tjera.
- » Viti 2021 nisi me Statutin e ri të AAB-së, i regjistruar ligjërisht në gjykatë në fillim të muajit shkurt.
- » Sipas statutit të ri u krijuan komitete të reja të përhershme dhe u emëruan kryetarët e tyre. U rishikuan rregulloret e reja të brendshme të komiteteve.
- » Zyra Ekzekutive u përfshi në procesin e konsultimit për 8 udhëzime të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si dhe për 2 (dy) projektligje (“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligj për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”).
- » Trajtohet çështja e llogarisë së posaçme të Përmbaruesit Privat, e cila në bazë të ligjit duhet të çelet nga bankat vetëm pasi ata të paraqesin numrin e tyre identifikues NIPT, krahas të gjitha dokumenteve të tjera të parashikuara në aktin nënligjor. Së bashku me Bankën e Shqipërisë u trajtua çështja e tarifave bankare për transaksionet nga llogaritë e përmbaruesve.
- » Është ndjekur procesi i krijimit të një regjistri kombëtar të llogarive bankare. Procesi u realizua më 28 qershor

sipas kërkesave të ligjit.

- » Ndjekje aktive e zbatimit të projektit të fiskalizimit, në bashkëpunim me DPT.
- » U organizua Takimi Veror i Bordit Mbikëqyrës me Guvernatorin.
- » U organizua dhe lehtësua seminari në bashkëpunim me institucionet shtetërore, Drejtorinë e Tatimeve dhe Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave.
- » Së bashku me AKCESK-un u organizua një seminar për sigurinë kibernetike me përfaqësues nga bankat.
- » U krye koordinimi me Ministrinë e Shëndetësisë për të mundësuar procesin e vaksinimit të punonjësve të sektorit bankar kundër COVID-19.
- » U krijua një "ekip trajnuesish" për PPP dhe u organizua trajnimi i tyre për hartimin e përmbajtjes së trajnimit. Gjithashtu, u zhvillua një trajnim didaktik.
- » 24 kurse trajnimi për sektorin bankar, të realizuara në bashkëpunim me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë dhe 341 kursantë nga bankat anëtare.
- » Është realizuar një fushatë ndërgjegjësuese për përdorimin e kartave si mënyrë pagese. Fushata zgjati dy muaj dhe u sponsorizua nga VISA.
- » Për herë të parë u organizua online Kuizi Evropian i

Parave, me pjesëmarrjen e 360 nxënësve të klasës së nëntë nga e gjithë Shqipëria.

- » Është arritur marrëveshja e sponsorizimit (me "Finance-In-Motion") për përkthimin dhe përshtatjen e librit "Hapat e parë në financë". Libri është një udhëzues funksional shtesë që do të përdoret në Konkursin Evropian të Kuizit të Parave në vitet e ardhshme. Projekti tani është në fazën e zbatimit..
- » Nisi bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, AMF dhe ANFE për strategjitë kombëtare për edukimin financiar.
- » Sekretariati ishte shumë aktiv në komunikim me institucione të ndryshme si: Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; FMN, Banka Botërore, EBF, BACEE, ICC dhe organizata të tjera lokale jofitimprurëse.
- » Prezencë aktive në media.
- » Nëpërmjet publikimeve periodike të buletinit mujor, statistika të ndryshme, revista (4 botime), raporti vjetor, raporti i CSR dhe statistika për përdorim të brendshëm.



FAKTE DHE SHIFRA 2021⁶

...Sektori bankar ka ruajtur tregues të mirë të përfitueshmërisë, likuiditetit dhe mjaftueshmërisë së kapitalit. Në veçanti, raporti i kredive me probleme ka vijuar të bjerë dhe ekspozimi i drejtpërdrejtë i aktivitetit të sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut është në nivele të kontrollueshme.

TE PËRGJITHSHME:



INSTAT jep një vlerësim paraprak të PBB-së për vitin 2021, i cili, mbështetur në vlerësimet tremujore, shënoi një rritje prej 8,54 %



2,0% norma mesatare e inflacionit në 2021



Deficiti i buxhetit prej 4,7 %



18,0% Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

13

KREDITË:




39,6% raporti i kredisë ndaj PBB



8,4% u rrit vëllimi i kredisë për sektorin privat - norma më e lartë e rritjes prej vitit 2012

⁶ Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë



9,3% u rrit kredia për individë



5,65% raporti i kredive me probleme - niveli më i ulët në dekadën e fundit




6,1% norma mesatare e interesit që individët kanë përfituar - nga 6,4% një vit më parë.



17,3% treguesi i refuzimit të aplikimeve për kredi

DEPOZITAT:



Norma mesatare vjetore e rritjes së depozitave 8,5%.



77,6% raporti i depozitave ndaj PBB-së

PAGESAT:



55,57% pëson në numër e pagesave me karta ndaj përdorimit të instrumenteve të pagesave



69% e popullsisë në moshë madhore zotëron një llogari pagese



12,5 pagesa elektronike për frymë nga 10 pagesa që është objektivi



20,98% rritja e llogarive të aksesueshme në distancë



69% e popullsisë në moshë madhore zotëron një llogari pagese



Rritje 15,45% në vëllimin e transaksioneve me bankungun nga shtëpia



24,5% rritje e vlerës së transaksioneve me bankungun nga shtëpia

BANKINGU NË CELULAR:



1,7 milionë transaksione ose rritje me 46,78%



219 miliardë lekë vlera e transaksioneve ose rritje vjetore prej 47,36%

KARTAT:



11,38% rritje e numrit të ATM-ve



49,87% rritje e vlerës së pagesave me kartë



43,63% rritje e numrit të pagesave me kartë



13,12% rritje e numrit të POS-ve

TË TJETRA:



421 degë dhe agjenci bankare

SHTYLLAT KRYESORE TË AAB-SË

Plani i biznesit AAB mbështetet fort në pesë shtylla kryesore dhe objektiva strategjike që mbështesin vizionin, misionin dhe qëllimet e Shoqatës.

- √ Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe bashkëpunimi me autoritetet
- √ Transformimi i sektorit bankar
- √ Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve të bankës
- √ Edukimi financiar
- √ Komunikimet, marrëdhëniet me publikun dhe mbrojtja ligjore

PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR DHE BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET

17

Kuadri ligjor dhe nënligjor

Përgjatë vitit 2021, sektori bankar nëpërmjet Zyrës Ekzekutive është përfshirë në procesin e konsultimit të disa projekt ligjeve dhe projektvendimeve të Këshillit të Ministrave, një pjesë e të cilëve më pas janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, apo nga autoritetet kompetente, si

- Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. Ndryshimet në përgjithësi synojnë të forcojnë masat mbrojtëse të sistemit financiar nga kërcënimet për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe e rreziqeve të pastrimit të parave, parandalimin e hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe zbulimin dhe goditjen e kësaj veprimtarie kriminale.
- Projektligji “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, i cili sjell risi të rëndësishme dhe komplekse për sektorin bankar. Si i tillë, sektori bankar përveç komente të dërguara, ka shprehur interesin dhe gatishmërinë që të japë kontributin e tij mbi të, duke ju nënshtruar një diskutimi gjithëpërfshirës në nivel teknik.
- Projekt vendimin e Këshillit të Ministrave “Për rregullat e aksesit të subjekteve të interesuara në bazën e të dhënave të Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”, kjo në kuadër të plotësimit të legjislationit mbi Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare.
- Projekt-udhëzimin “Për formatin e së raportimit të të dhënave, në zbatim të ligjit nr. 154/2020 “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”.
- Projekt rregulloja e hartuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare “Për formën dhe përmbajtjen e prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar”.

Kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë

Shoqata Shqiptare e Bankave është angazhuar dhe ka bashkëpunuar me Bankën e Shqipërisë përgjatë 2021.

- Projekt rregulloren për disa ndryshime në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, të cilat konsistojnë në ndryshimin /zëvendësimin e normave të interesit të referencës (indekset e referencës /IBOR-et) dhe prezantimin e “klauzolës së ndryshimit të indeksit orientues”, duke synuar kështu zbutjen e rreziqeve drejt kalimit sa më normal dhe efektiv tek normat e reja të referencës..
- Projekt rregulloren për disa ndryshime në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, duke synuar harmonizimin e mëtejshëm të rregullores me kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të kërkesave të autoritetit rregullator për mbrojtjen e konsumatorit.
- Projekt rregulloren për disa ndryshime rregulloren “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, ndryshime të ardhura në kuadër të përafrimit të kuadrit rregullator me kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian.
- Projekt rregulloren për disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të cilat kanë për qëllim trajtimin më të favorshëm për peshat e rrezikut që aplikohen ndaj ekspozimit të bankave në tituj borxhi të qeverisë shqiptare në valutë, të emetuar gjatë vitit 2021, si dhe për kredinë ndaj OSHEE-së të vitit 2021, të garantuar nga qeveria shqiptare.
- Projekt rregulloren për një ndryshim në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”. Ky ndryshim parashikonte ruajtjen e të njëjtit nivel klasifikimi dhe provigjionimi për kreditë e ristrukturuara deri më 31 mars 2021, me klasifikimin dhe provigjionimin që kishin përpara ristrukturimit, kjo në kuadër të masave të marra si pasojë e pandemisë së COVID-19.

Bashkëpunimi me autoritetet

Ligji Antimafia

Më 22 korrik 2021, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, përmes një shkrese zyrtare drejtuar Bankës së Shqipërisë, ka paraqitur shqetësimet e tij lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor, të njohur ndryshe si ligji Antimafia. Ai bëri një prezantim shterues të pozicionit ligjor të bankave në rastet kur ato janë të përfshira si palë të treta në procedime/hetime sipas këtij kuadri ligjor, i cili përcakton procesin e sekuestrimit/konfiskimit të aseteve që bankat kanë të drejta reale para-prake. Përmes kësaj shkrese është kërkuar ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë për të ndërmarrë disa nisma për ndryshimet e nevojshme në ligjin ekzistues..

Për fiskalizimin

Gjatë vitit janë zhvilluar disa takime për procesin e fiskalizimit. Këto takime rezultuan tejet konstruktive dhe bankat u angazhuan në seancat e pyetjeve dhe përgjigjeve, të fokusuara në disa nga çështjet më kryesore teknike të industrisë bankare për projektin.

Zyra Ekzekutive e AAB-së realizoi koordinimin e komunikimin me bankat pas takimeve dhe vijoi shkëmbimin e problematikave dhe pyetjeve lidhur me sektorin bankar me Grupin e Punës për Fiskalizimin e DPT-së dhe përfaqësuesit e bankave. Më konkretisht, gjatë gjithë vitit:

- √ Më 15 janar 2021, 75 përfaqësues teknikë nga bankat morën pjesë në takimin online me përfaqësues të grupeve të punës për fiskalizimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në vijim të këtij takimi, më 29 janar 2021, Zyra Ekze-

kutive e AAB-së, me anë të një shkrese drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), kërkoi që për sa i përket pagesave të detyrimeve të klientëve/tatimpaguesve, përveç asaj që parashikon formati aktual, të vendoset një formë e re komunikimi në kohë reale ndërmjet bankës dhe DPT-së në rast se banka merr një kërkesë nga një kanal tjetër komunikimi nga Blerësi (jo përmes urdhërpaguesës), në mënyrë që bankat të pasqyrojnë në kohë reale detyrimet e klientit/tatimpaguesit.

- √ Më 1 mars dhe 28 maj 2021 u organizuan takime online për palët e grupit të punës. Në këto takime ishin të pranishëm përkatësisht 45 dhe 70 përfaqësues të bankave, të cilët ndanë dhe diskutuan me përfaqësuesit e DPT-së shqetësimet e tyre lidhur me çështjet kyçe të sektorit bankar që lidhen me procesin e fiskalizimit.
- √ Për sa i përket zbatimit, u organizuan dy takime teknike online përkatësisht në datat 3 dhe 10 maj, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bankave, DPT-së dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Në këto takime morën pjesë përkatësisht 91 dhe 82 përfaqësues të bankave dhe DPT-së.
- √ Në datën 3 qershor, në vijim të shqetësimeve të bankave për procesin e fiskalizimit, konkretisht për pengesat objektive (mungesa e dokumenteve teknike përfundimtare të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) për zbatimin e procesit të fiskalizimit, Zyra Ekzekutive e AAB-së, përmes një shkrese drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe për dijeni DPT-së, kërkoi shtyrjen e afatit të caktuar, duke qenë se fiskalizimi për transaksionet jo-cash ndërmjet tatimpaguesve (B2B) do të fillonte në 1 korrik 2021. Nëse nuk do të realizohej kjo, u kërkua që të merrej në konsideratë një periudhë testimi për procedurat pa penalitete ligjore.
- √ Më 19 korrik, AAB së bashku me ICC Albania organizuan një takim të përbashkët me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Ky takim u fokusua në shqetësimet e ngritura nga bankat anëtare lidhur me Letër Kredinë dhe Garancinë, në kuadër të procedurave të fiskalizimit. Kjo çështje i është bërë me dije më parë autoritetit përmes një shkrese zyrtare. Pas shkëmbimit të këndvështrimeve mbi këtë temë, përfaqësuesi i DPT-së u shpreh se do të angazhohej për t'iu përgjigjur zyrtarisht dhe ndoshta për të rishikuar specifikimet teknike të dokumentit të faturave elektronike.
- √ Më 28 shtator, Zyra Ekzekutive e AAB-së, përmes një shkrese drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka vënë në dukje problematikën e zbatimit të procesit të fiskalizimit. Në këtë drejtim, AAB-ja kërkoi rifillimin në një kohë sa më të shpejtë të komunikimeve javore për trajtimin e çështjeve bankare.
- √ Më 16 dhjetor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së mori pjesë në takimin me Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve, ku u trajtuan shqetësimet e bankave në lidhje me projektin e fiskalizimit, veçanërisht për gjobat e vendosura pas inspektimeve fiskale nga 1 janari 2022. Ata diskutuan lidhur me mundësinë e shtyrjes së penaliteteve për gjysmën e parë të vitit 2022.

Komiteti Drejtues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Më 5 nëntor 2021, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së mori pjesë në Komitetin Drejtues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të kryesuar nga Ministri i Financave. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Tatimeve. Përfaqësuesit e AAB-së trajtuan shqetësimet e sektorit bankar lidhur me procesin e fiskalizimit. Në këtë drejtim, u kërkua rivendosja e komunikimit për çështjet teknike me Grupin e Fiskalizimit të DPT-së. Më tej, u theksuan disa çështje lidhur me zbatimin e ligjit "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare".

Më 12 nëntor 2021, përfaqësues të të gjitha bankave anëtare dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së morën pjesë në një takim me Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Tatimeve dhe përfaqësues të tjerë të institucionit. Pjesëmarrësit në këtë takim diskutuan shqetësimet e bankave në lidhje me procesin e fiskalizimit dhe siguruan se do të vazhdonin të shkëmbejnë komunikime të natyrës teknike midis palëve të interesit për këtë çështje.

Standardet e Zakonshme të Raportimit (CRS)

Edhe gjatë vitit në shqyrtim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve vijoi të diskutonte dhe të trajtonte problematikat në lidhje me çështjet kryesore të këtij sektori. Më datë 16 Prill 2021, u organizua një takim mes bankave dhe përfaqësuesve të DPT-së. Takimi u fokusua në çështjet kryesore të bankave lidhur me raportimin vjetor/periodik sipas SRK. Të pranishëm ishin 31 përfaqësues teknikë.

Skema e garancisë shtetërore

Më 21 janar, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (MFE) iu drejtua një shkresë ku kërkohej shtyrja e afatit për bizneset që aplikojnë për skemat përkatëse të garancisë, deri më 30 qershor 2021. Në këtë propozim drejtuar MFE-së, bankat vlerësuan të nevojshme një tjetër zgjatje të afatit të aplikimit në kuadër të kësaj skeme kredie me mbështetje shtetërore, duke qenë se ka ende subjekte të interesuara për të përfituar prej saj. Bankat kanë aplikime që janë ende në proces vlerësimi, të cilat rrisin vazhdimisht vlerën e përdorimit të mbështetjes së garantuar nga shteti.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë njoftoi se u miratua zgjatja e afatit për aplikimet në kuadër të skemës së garancisë shtetërore me qëllim rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar.

Shkresë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK)

Pas kërkesës së Agjencisë së Kadastrës për bashkëpunim me sektorin bankar për aktet e miratuara dhe problematikat me të cilat ballafaqohen ato në zbatimin e tyre, më 2 shkurt, AAB trajtoi problematikat dhe shqetësimet e unifikuara të bankave anëtare për zbatimin e kuadrit ligjor të miratuar..

20

Për shpërndarjen e dividendit për vitin 2020

Më 25 mars, Kryetari i AAB-së i drejtoi një kërkesë Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë lidhur me rishikimin e vendimit për mosshpërndarjen e dividendit të vitit 2020. Kjo kërkesë bazohet në rezultatet e sektorit bankar dhe situatës së tij në fund të gjysmës së parë të vitit 2021.

Vaksinimi i punonjësve të bankës

Në datën 8 prill, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i është dërguar një shkresë, ku kërkohej që punonjësit e bankave të shqyrtohen me prioritet lidhur me vaksinimin kundër Covid-19, duke vënë në dukje se ata janë në vijën e parë të kontaktit të drejtpërdrejtë me klientët. Kjo kërkesë bazohet në politikat e vaksinimit për grupmoshat apo profesionet dhe në faktorët e rrezikut..

Në datën 28 qershor, nën koordinimin e Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe në bashkëpunim me departamentet e Burimeve Njerëzore të bankave anëtare, nisi procesi i vaksinimit të punonjësve të sektorit bankar kundër COVID-19.

TRANSFORMIMI I SEKTORIT BANKAR

Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare

Miratimi i ligjit "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare" përcakton kuadrin ligjor dhe dispozitat e qasjes së sigurt në të dhëna të caktuara të llogarive dhe institucioneve bankare, të cilat kanë të drejtë qasjeje. Me fokus të veçantë gjatë muajit mars, Zyra Ekzekutive e AAB-së ka dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë disa çështje/propozime kyçe për këtë akt legjislativ në përgjigje të kërkesave të institucionit.

Konkretisht:

- Më 3 mars është zhvilluar një takim online me bankat dhe përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të diskutuar çështjet kryesore të raportimit të të dhënave. Në takim morën pjesë 50 përfaqësues të bankave. Në vijim të këtij takimi, Zyra Ekzekutive e AAB-së vijoi angazhimin e saj për shkëmbimin e problematikave dhe pyetjeve me DPT për raportimin e të dhënave në sektorin bankar.
- Në datën 8 mars, Zyra Ekzekutive e AAB-së depozitoi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë disa komente/sugjerime për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për rregullat e aksesit të subjekteve të interesuara në bazën e të dhënave të Regjistrit Qendror të Llogarive Bankare".
- Më 19 mars, komentet e bankave për projektvendimin përfundimtar iu dërguan Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Në datën 25 mars, sektori bankar dorëzoi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë disa çështje/propozime kyçe për projekt udhëzimin "Për formatin e dosjes së raportimit të të dhënave sipas ligjit nr. 154/2020 "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare".
- Më 10 maj, AAB i dërgoi një shkresë Ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ku theksonte problematikat kryesore të natyrës teknike dhe shqetësimet e bankave për raportimin e të dhënave në Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare.
- Zyra Ekzekutive e AAB-së vendosi një komunikim të gjerë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të parashtruar problematikat kryesore të bankave lidhur me raportimin e të dhënave në llogarinë e Regjistrit Qendror të Bankave.
- Në datat 17 dhe 22 qershor, u organizuan dy takime online ku morën pjesë përfaqësues të bankave, DPT-së dhe AKSHI-it, për të diskutuar problematikat kryesore të ngritura nga sektori bankar për raportimin e të dhënave të llogarive bankare.

SEMINARE DHE WEBINAR-E

Trajnim mbi Falimentimin në bashkëpunim me IFC:

- Në datat 23-25 mars u organizua një trajnim online “Për juristët dhe palët e interesit të Bankës mbi problematikat reale të falimentimit në Shqipëri”. Në trajnim morën pjesë 26 avokatë të bankave dhe të gjithë pjesëmarrësve iu shpërndanë certifikata.
- Në datat 14-15 prill u organizua një trajnim online me temë “Aplikimi i ndërmjetësimit për zgjidhjen e çështjeve të falimentimit në Shqipëri”. Në këtë takim morën pjesë 19 avokatë të bankave, të cilët u pajisën me certifikata.

Webinar për projektligjin e ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Më 30 korrik, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e Informacionit dhe të Dhënave zhvilloi një seminar prezantues online mbi kuadrin e ri rregullator, pjesë e Projektit të Binjakëzimit “Ndërtimi i kapaciteteve të institucionit për përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale”. Të pranishmit nga sektori bankar dhe telekomunikacioni u njohën me risitë që sjell ligji i ri kombëtar dhe ndikimi i tij në sektorin bankar/financiar dhe në atë të telekomunikacionit. Në këtë aktivitet morën pjesë folës nga Autoriteti Italian i Mbrojtjes së të Dhënave, CSI-Piemonte në Itali dhe Zyra e Komisionerit. Nën koordinimin e Zyrës Ekzekutive të AAB-së, në këtë seminar online morën pjesë 60 përfaqësues të bankave.

Stërvitja Kibernetike Financiare

Në datat 17-18 nëntor, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë with the Albanian Association of Kibernetike (AKCESK), në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB), në përmbushje të detyrave dhe objektivave funksionale të “Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike”, organizoi Stërvitjen Kibernetike në fushën Financiare. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte ngritja e kapaciteteve të sektorit financiar, si një nga sektorët më të ndjeshëm në nivel kombëtar. Në këtë aktivitet morën pjesë 13 pjesëmarrës nga bankat anëtare.

22



Pagesat me kodin QR

Më 4 nëntor, AAB organizoi prezantimin online mbi pagesat me kodin QR, duke mbledhur rreth 35 pjesëmarrës përfaqësues të bankave anëtare. Përfaqësuesi i Symmetric Group prezantoi platformën me kosto efektive për të lehtësuar pagesat me kodin QR midis tregtarëve dhe bankave duke përdorur platformën e tyre novatore.

Seminar online mbi pranimin e pagesave elektronike

Në datën 13 dhjetor, Banka e Shqipërisë, me mbështetjen e Bankës Botërore, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë për Individë (NRVPS), organizoi një seminar online me temë “Pranimi i pagesave me kartë”, i cili synoi të rrisë ndërgjegjësimin e palëve të interesit për shërbime më efikase në këtë segment tregu. Në këtë seminar morën pjesë disa përfaqësues të bankave.

TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI I PUNONJËSVE TË BANKËS

AAB është burimi më i gjerë i trajnimit për profesionistët e bankave.

GJATË VITIT,

- u zhvilluan trajnime për më shumë se **24** tema të ndryshme;
- janë trajnuar mbi **340** punonjës të bankave;
- në bashkëpunim me **7** partnerë.

Tema: Identifikimi dhe zbutja e mashtrimit dhe veprimeve dashakeqëse

Data: 2-4 shkurt 2021

Partnerë: Instituti Shqiptar i Auditorëve të Brendshëm (AIIA)

Pjesëmarrja: 11 pjesëmarrës

Përshkrimi: Ky program u krijua për të rishikuar dhe përditësuar pjesëmarrësit mbi tendencat dhe sjelljet aktuale të atyre që kërkojnë, me ose pa dashje, t'i shkaktojnë organizatës humbje ose dëme.



Tema: Të menduarit sipas dizajnit

Data: 16-17 shkurt dhe 24 shkurt 2021

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)

Pjesëmarrja: 17 pjesëmarrës

Përshkrimi: Ky trajnim vuri në dispozicion një përmbledhje të parë, por të thellë të të menduarit sipas dizajnit si një metodë për menaxhimin e inovacionit të shërbimit, produktit, procesit dhe modelit të biznesit, duke u dhënë mundësi praktikuesve të mësojnë nëpërmjet rasteve praktike.

Tema: Planifikimi Strategjik

Data: 9-11 mars 2021

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)

Pjesëmarrja: 14 pjesëmarrës

Përshkrimi: Qëllimi i këtij kursi ishte të ofrojë njohuri për zhvillimin e hartave strategjike.

Tema: Financa e Projektit

Data: 23-26 & 30-31 mars 2021

Partnerë: ATTF / House of Training Luxembourg

Pjesëmarrja: 15 pjesëmarrës

Përshkrimi: Ky kurs prezantoi konceptet bazë në fushën e financimit të projekteve, duke u ofruar 15 pjesëmarrësve një pasqyrë të temës për të ndërvepruar me specialistë ose për të vijuar studime më të thelluara në fushat e interesit.



Tema: Trajnim pragmatik për lidhshpim për certifikimin 7 CPAL
Data: 6-8 prill 2021
Partnerë: AGISOLVE
Pjesëmarrja: 12 pjesëmarrës

Përshkrimi: Në këtë kurs u theksua se sa e rëndësishme është që organizatat në fushën e financave dhe bankave të bëhen edhe më të përgjegjshme, më adaptive dhe më të shkathëta për të përmbushur kërkesat në ndryshim të klientëve dhe zhvillimet e tregut.

Tema: Menaxhimi i rrezikut në sektorin bankar
Data: 13-16 prill dhe 22-23 prill 2021
Partnerë: ATTF / Qendra e Trajnimeve, Luksemburg
Pjesëmarrja: 14 pjesëmarrës

të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) – Gjendjes Civile, për dorëzimin e certifikatës së lindjes për pensionistët, si dhe për mundësinë e rishikimit të Udhëzimit nr.130, datë 05.03.2018 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike". Takimi u karakterizua nga një mirëkuptim i ndërsjellët nga të dyja palët dhe angazhimi për bashkëpunim të mëtejshëm..

Në vijim të këtij takimi, Zyra Ekzekutive e AAB-së, përmes një shkrese zyrtare drejtuar Ministrit të Brendshëm, prezantoi rreziqet e sigurisë fizike në sektorin bankar dhe parashtrori disa propozime për përmirësime të mëtejshme.

Më 14 dhjetor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së zhvilloi një takim me Drejtorin e Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke u fokusuar në procesin e vlefshmërisë së statusit jetësor të një pensionisti. Palët ranë dakord të vijnë takimet teknike për të diskutuar më tej dhe për të gjetur mënyrën më të mirë për të përmirësuar bashkëpunimin dypalësh për llogaritë e pensioneve.

Takim me Zëvendëskryeministrin

Më datë 6 dhjetor 2021, Bordi Mbikëqyrës i AAB-së, i kryesuar nga Kryetari i AAB-së, z. Bledar Shella, zhvilloi një takim me Zëvendëskryeministrin e Shqipërisë dhe Ministrin e Shtetit për Programin e Rindërtimit dhe Reformës, z. Arben Ahmetaj. Z. Ahmetaj u njoh nga anëtarët e Bordit me problematikat kyçe që lidhen me zhvillimin ekonomik, digjitalizimin dhe projektet për vitin 2022. Gjithashtu, palët diskutuan se si të përmirësohet më tej bashkëpunimi mes industrisë bankare dhe institucioneve publike.



Takim me Kryeadministratorin e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Më 14 tetor, Kryetari i Komitetit Ligjortë AAB-së së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së morën pjesë në takim me përfaqësues të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Takimi u përqendrua tek drejta reale e palëve të treta gjatë procesit të konfiskimit të pasurive sipas ligjit antimafia dhe ndryshimet e mundshme të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, duke synuar shpërndarjen e të ardhurave tek të tretët me të drejta reale mbi pasuritë e konfiskuara dhe të shitura.

Takim me Ministrin e Drejtësisë

Më datë 12 tetor 2021, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të AAB-së, të kryesuar nga Kryetari i Bordit z. Bledar Shella zhvilluan një takim zyrtar me Ministrin e Drejtësisë z. Ulsi Manja. Ndër temat kryesore të diskutimit ishin të drejtat e bankave në pozicionin e tyre si kreditore për pasuritë e konfiskuara, nevoja për ndryshime në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe çështje që lidhen me shërbimin e përmbarimit gjyqësor privat.

Takim me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Më 28 tetor 2021, AAB mori pjesë në një takim me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: Zëvendësministret Adela Xhemali dhe Vasilika Vjero dhe z. Arlind Gjokuta, Sekretar i Përgjithshëm..

Diskutimi u fokusua në çështjet e industrisë bankare që lidhen me ecurinë e zbatimit të projektit të fiskalizimit, emetimin e eurobondit të pestë, draft ndryshimit të fundit në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, si dhe probleme të tjera të hasura gjatë zbatimit të ligjit “Për regjistrin e llogarive bankare”. Gjithashtu, u diskutua çështje lidhur me bashkëpunimin dhe koordinimin e mundshëm për çështjet e pagesave për shërbimet publike dhe shtetërore nëpërmjet platformës e-Albania, si dhe qasjen në të dhënat e kësaj platforme..

Takime me institucione ndërkombëtare

Takime me Bankën Botërore

Më 21 tetor 2021, anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të AAB-së u pritën në një takim nga Menaxheri i Bankës Botërore për Shqipërinë, z. Emanuel Salinas. Gjatë këtij takimi, Kryetari i AAB-së, z. Shella theksoi problematikat me të cilat po përballon industria bankare lidhur me kërkesat për kapital në kuadër të zbatimit të kërkesave të Basel III dhe rishikimit të primit të sigurimit për depozitat. Anëtarët theksuan çështjen e përmbarimit privat, e cila mbetet ende e pazgjidhur. Z. Salinas, së bashku me përfaqësues të tjerë të Bankës Botërore, shprehën mirëkuptimin e tyre lidhur me shqetësimet e ngritura dhe u shprehën se do të kryejnë një analizë më të thelluar përpara se të japin opinionin apo qëndrimin e tyre. Ky takim u zhvillua në frymën e një mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe përkushtimi për komunikime të mëtejshme.

Takim online me ekipin e Komisionit Evropian të DG NEAR

Në datat 16-18 nëntor 2021, ekipi i Komisionit Evropian nga DG NEAR, DG ECFIN dhe DG EMPL (punësimi) diskutuan në një takim online me autoritetet shqiptare mbi Programin e Reformës Ekonomike në Shqipëri (PRE) 2022-2024, i cili është në proces hartimi. Një nga çështjet e diskutuara gjatë misionit ishte edukimi financiar, përfshirja financiare dhe qasja në financa, si dhe Strategjia e Edukimit Financiar.

Duke pasur parasysh se bankat luajnë një rol kyç dhe nisur nga vëmendja e veçantë të Bankës Botërore në këtë fushë, më 16 nëntor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së zhvilloi një takim me znj. Sarah Jurreit nga DG ECFIN dhe z. Andrew Williams nga DG NEAR.

Takimi mbi klimën kuadër të biznesit për bujqësinë

Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) ka iniciuar një studim për sektorin e sigurimeve në fushën e bujqësisë në Shqipëri, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU). Bëhet fjalë për palët e interesit në sektorin e bujqësisë (fermerët tregtarë, pronarët e vegjël në zinxhirin e vlerës, agrobizneset, fermerët e orientuar drejt eksportit) që mund të jenë të interesuar të blejnë sigurime bujqësore për investimin e tyre dhe që mund të përballojnë një sigurim të tillë (p.sh. sigurim me indeks të shumëfishtë rreziku). Një pikë tjetër diskutimi ishte blerja nga ana e bankave e këtij lloj sigurimi për të zvogëluar rrezikun e saj të huadhënies në këtë sektor. Për këtë studim, më 20 maj 2021, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së së bashku me përfaqësuesin e pesë bankave të përfshira në kreditimin për sektorin e bujqësisë (BKT, Credins Bank, Tirana Bank, OTP Bank Albania, Intesa Sanpaolo Bank Albania) zhvilloi një takim me përfaqësuesit e Business & Finance Consulting GmbH (BFC), një shoqëri konsulente me bazë në Zvicër, e cila ka marrë përsipër të kryejë këtë studim në emër të KfW.

Shqipëria: 2021 Neni IV Deklarata Përmbyllëse e Konsultimeve

Më 5 tetor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u takua me misionin e FMN-së të kryesuar nga znj. Magali Pinari. Këto misione u ndërmorrën si pjesë e konsultimeve të rregullta sipas Nenit IV të Neneve të Marrëveshjes së FMN-së, në kontekstin e një kërkesë për të përdorur burimet e FMN-së si pjesë e monitorimit të zhvillimeve ekonomike.

Agjenda e takimit përfshinte zhvillimet e fundit në sektorin bankar, rreziqet për bilancet bankare dhe stabilitetin financiar, mjedisin dhe perspektivën makroekonomike, performancën e bankave, raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, rritjen e kredisë sipas sektorëve, performancën e kredive të ristrukturuara, ndryshimet rregullatore, statusin e NPL-ve dhe kuadrin e zgjidhjes së tyre, shpërndarjen e fitimit, ndryshimin e peizazhit të sistemit bankar, sektorin e pasurive të paluajtshme, oreksin e bankave për titujt qeveritarë..

Takime konsultative për kuadrin e bashkëpunimit

Gjatë vitit, Zyra Ekzekutive e AAB-së zhvilloi takime me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, si Banka Botërore, ATTF Qendra e Trajnimeve Luksemburg, ANFE, ICC Albania dhe organizata të tjera, për të kuptuar më mirë problematikat aktuale kryesore me të cilat përballlet sektori bankar dhe të gjitha palët gjatë aktivitetit të tyre të përditshëm. Të pranishmit në këto takime diskutuan lidhur me mënyrat se si mund të forcohet bashkëpunimi ndërmjet OJQ-ve për të arritur qëllimet e përbashkëta dhe për të pasur një qëndrim të përbashkët në bashkëpunimin efektiv me organet legjislativë shtetërore.

Takime informuese

- Më 24 mars, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së zhvilloi një takim virtual me ekipin e Bankës Botërore. Gjatë këtij takimi, z. Brumbullu prezantoi një pasqyrë të sektorit bankar dhe projektin për raportet në Bankën e Shqipërisë sipas standardeve SNRF.
- Më 5 nëntor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së mirëpriti në takim Drejtorin Ekzekutiv të Qendrës AlHuda CIBE, z. Muhammad Zubair. Qendra AlHuda e Bankingut dhe Ekonomisë Islamike (CIBE) është një emër i njohur në sektorin e Bankingut dhe Financave Islamike, i cili fokusohet në trajnimin, ndërgjegjësimin, këshillimin dhe publikimet lidhur me Bankingun dhe Financat Islamike për të promovuar industrinë..



SHIFRA
RRETH
BANKAVE
ANËTARE

Të dhënat e audituara sipas IFRS, në 31.12.2021 ((1 EUR = 120.76 lekë; 1 USD = 106.54 lekë) (në mijë ALL))

Banka	Struktura e Aksionarëve		Vendi i origjinës	Aktive gjithsej	Hua neto		Investime në letra me vlerë	
					Retail	Biznes	të Qeverisë Shqiptare	të tjera
 ALPHA BANK	Alpha International Holdings Single Member S.A.	100%	Greqi	79,978,928	15,142,935	20,672,948	12,945,517	9,125,847
 AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	Tranzit Sh.p.k.	100%	Shqipëri	98,465,613	10,520,845	25,295,461	39,545,179	3,817,666
 BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	Calik Holding A.S.	100%	Turqi	464,120,703	36,333,540	52,882,952	142,551,665	106,517,350
 CREDINS bank	Renis Tershana	18.16%	Shqipëri	282,269,487	18,371,618	100,362,877	49,096,427	42,422,122
	Aleksander Pilo	7.68%	Shqipëri					
	B.F.S.E. Holding BV	15.13%	Hollandë					
	Amryta Capital LLP	6.42%	Angli					
Të tjerë	52.61%							
 Fibank First Investment Bank	Fibank AD	100%	Bullgari	41,883,294	8,862,030	11,783,961	11,313,162	279,149
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	Intesa Sanpaolo S.p.A.	100%	Itali	195,670,561	13,998,207	38,969,636	68,835,156	5,300,223
 ProCredit Bank	ProCredit Holding AG & Co. KGaA	100%	Gjermani	38,216,886	2,035,527	25,184,414	1,700,596	-
 Raiffeisen BANK Pjesë e Grupit RBI	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH	100%	Austri	272,878,304	43,897,100	63,108,222	67,925,887	13,971,164
 otpbank	OTP NYRT	100%	Hungari	114,402,467	31,843,884	41,552,370	25,111,835	-
 TIRANA BANK	Balfin Sh.p.k.	100%	Shqipëri	97,077,570	14,765,430	30,043,285	31,529,886	4,864,830
 UNIONBANK	Unioni Financiar Tirane (UFT) Sh.p.k.	96.46%	Shqipëri	80,492,818	15,965,995	19,729,467	26,255,680	1,500,252
	Individë	3.54%						
 UBA United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqipërisë	Banka Islamike e Zhvillimit	72.2%	Arabia Saudite	11,982,495	2,678,961	4,561,474	-	-
	Eurosig Sh.a.	21.02%	Shqipëri					
	Ithmaar Bank B.S.C.	4.3%	Arabia Saudite					
	Investitorë të tjerë	2.48%	Arabia Saudite					
Gjithsej				1,777,439,125	214,416,072	434,147,067	476,810,991	187,798,603

Kapitali i vet	Depozita	Fitimi neto	Nr. i degëve	Nr. i punonjësve	Nr. ATM	Nr. i kartave të lëshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	E-banking	Mobile Banking	E-commerce
9,070,686	65,612,784	50,624	34	410	49	41,796	37,200	4,596	1,310	✓	✓	✗
10,515,713	72,246,941	1,403,312	21	349	30	19,276	18,331	945	-	✓	✓	✗
52,472,479	365,243,683	7,723,400	63	939	107	382,332	333,934	48,398	7,345	✓	✓	✓
20,155,970	250,755,071	1,252,116	57	1006	69	198,806	129,668	6,127	1,946	✓	✓	✓
4,235,850	34,332,798	615,307	14	367	38	40,613	36,799	3,814	-	✓	✓	✗
22,326,699	169,461,419	519,679	35	659	60	112,105	111,437	668	668	✓	✓	✗
3,262,268	26,508,640	74,878	7	124	16	9,999	9,948	51	-	✓	✓	✗
29,178,697	225,126,692	3,444,698	74	1265	180	313,327	281,977	31,350	2,129	✓	✓	✓
11,292,168	82,377,573	1,912,291	39	480	143	74,938	70,203	4,735	-	✓	✓	✗
10,829,484	82,410,517	865,029	35	501	70	73,983	67,974	6,009	235	✓	✓	✗
6,744,325	68,041,346	1,033,450	32	418	56	47,495	41,084	6,411	137	✓	✓	✓
1,198,273	10,252,756	28,439	6	91	0	1,896	5,398	-	-	✗	✗	✗
181,282,610	1,452,370,220	18,923,222	417	6609	818	1,316,566	1,143,953	113,104	13,770	11	11	4

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasherri, Kompleksi T.I.D, Shk. B
Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 44 525 880
M +355 69 4014 701
www.granthornton.al
contact@al.gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin e organizates “Shoqata Shqiptare e Bankave”,

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të “Shoqata Shqiptare e Bankave”, (“më poshtë referuar si “Organizata”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e aktiviteteve dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizates me datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e shpenzimeve sipas aktiviteteve dhe flukseve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizates për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Organizaten ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizates.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
29 mars 2022

Median Kodra, FCP




Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	4	3,752,601	5,649,688
Kontribute të arkëtueshme	5	937,315	288,990
Shpenzime të parapaguara	6	480,160	280,160
Totali i aktiveve afatshkurtra		5,173,076	6,218,838
Aktivët Afatgjatë			
Aktivët e qëndrueshme, neto	7	657,862	743,274
Totali i aktiveve afatgjatë		657,862	743,274
TOTALI I AKTIVEVE		5,830,938	6,962,112
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	8	676,699	728,934
Totali i detyrimeve afatshkurtra		676,699	728,934
Aktivët Neto	9	5,154,239	6,233,178
TOTALI I DETYRIMEVE		5,830,938	6,962,112

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri në 9, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave janë përpiluar më 18 shkurt 2022 dhe nënshkruar nga:


Spiro BRUMBULLI
Sekretar i Përgjithshëm
Shoqata Shqiptare e Bankave




PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k
Hartuesi



Pasqyra e Aktiviteteve

	Shënime	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
TË ARDHURAT			
Të ardhura nga kuotat e anëtarësisë	10	24,378,915	23,239,500
Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	10	4,777,493	4,303,950
Të ardhura të tjera	10	<u>3,651,623</u>	<u>1,982,878</u>
Totali i të Ardhurave		<u>32,808,031</u>	<u>29,526,328</u>
SHPENZIMET			
Amortizimi	7	(150,688)	(189,685)
Shpenzime organizimi për aktivitete	11	(11,271,959)	(8,391,416)
Shpenzime promovimi dhe publikime	12	(3,206,910)	(3,392,026)
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	13	(19,213,499)	(19,043,111)
Fitime/(Humbjet) nga kursi i këmbimit		<u>(43,935)</u>	<u>24,050</u>
Totali i Shpenzimeve		<u>(33,886,971)</u>	<u>(30,992,188)</u>
Ndryshimi në aktivet neto			
		<u>(1,078,940)</u>	<u>(1,465,860)</u>
Aktivët Neto në fillim të vitit		<u>6,233,179</u>	<u>7,699,039</u>
Aktivët Neto në fund të vitit		<u>5,145,239</u>	<u>6,233,179</u>

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri 9, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shoqata Shqiptare e Bankave
Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2021

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<i>Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit</i>			
Teprica/(Deficiti) i të ardhurave ndaj shpenzimeve		(1,078,940)	(1,465,860)
Rregullime për:			
Amortizim	7	150,668	189,685
Pakësime për nxjerrje jashtë përdorimi AAM	7	37,442	-
Llogari të arkëtueshme	5	(648,325)	2,146,410
Parapagime	6	(203,000)	-
Pagesa për llogaritë e pagueshme	8	(52,235)	(2,286,191)
Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit		(1,794,389)	(1,415,956)
<i>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</i>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	7	(102,698)	(9,368)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		(102,698)	(9,368)
RËNIE NETO E MJETEVE MONETARE		(1,897,088)	(1,425,324)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	4	5,649,688	7,075,012
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	4	3,752,601	5,649,688

Pasqyra e Flukseve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri 9, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shenime për pasqyrat financiare

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Ap.3, Tiranë, Shqipëri.

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 12 anëtarë, mbi baza vullnetare: Banka Alpha Albania sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka Credins sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., Banka Intesa SanPaolo Albania sh.a., Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka OTP Albania sh.a., Banka Procredit sh.a., Banka Raiffeisen sh.a., Banka Tirana sh.a. dhe Banka Union sh.a.

AAB ka pasur 6 punonjës me 31 dhjetor 2021 (2020: 6).

2. Baza e Përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me SKK për OJF-të dhe ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. SKK për OJF-të ka hyrë në zbatim nga data 1 janar 2016.

Pasqyrat Financiare paraqiten në Lekë (Lekë), e cila është dhe monedha funksionale e Shoqatës.

(a) Kosto Historike

Elementët në pasqyrat financiare janë njohur me koston historike.

(b) Parimi i vijmësisë

Pasqyrat financiare përgatiten sipas parimit të vijmësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e Shoqata Shqiptare e Bankave do të ketë vijmësi, dhe se nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj.

Organizata nuk e ndërpreu punën e saj gjatë pandemisë globale. Gjithashtu edhe të gjitha Bankat anëtare të Shoqatës vijuan aktivitetin e tyre pa ndërpreje, ndryshe nga pjesa me e madhe e entiteteve të cilat paten efekte prej masave kufizuese të qeverisë.

Gjatë vitit 2021 të gjithë donatorët e organizatës kanë disbursuar fondet e tyre në bazë të Statutit të organizatës në përputhje me planin e aktiviteteve për vitin 2021. Instalimi i fundit i vitit 2021 është miratuar me vendim të kuvendit të datës 15.12.2021. Asambleja e përgjithshme e organizatës me vendimin nr.5 datë 15.12.2021 ka miratuar planin financiar për vitin 2022 në shumën totale 38 570 092 lekë..

Organizata vijon me implementimin e masave për parandalimin e ndikimeve negative të Pandemisë në aktivitetet e saj dhe vlerëson se do të vijojë aktivitetin bazuar mbi parimin e vijmësisë, për një periudhë kohe të paktën për 12 muajt e ardhshëm.

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

I. Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë si të ardhurat që lidhen me to.

Të ardhurat kryesore të Shoqatës vijnë nga tarifat e anëtarësimit, të cilat janë subjekt i miratimit të Asamblesë së Anëtarëve.

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet regjistrohen kur ndodhin.

II. Transaksionet në monedhë të huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un. Të gjitha kontributet dhe pjesa më e madhe e shpenzimeve janë në Lekë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e datës së kryerjes së transaksionit. Të gjitha balancat në monedhë të huaj në fund të vitit janë konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të vitit si vijon:

Kursi i këmbimit më

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
LEKË/EUR	120.76	123.7

III. Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Vlerësimi fillestar i elementeve që plotësojnë kriteret e njohjes si AAM në bilanc është bërë me koston e blerjes plus kostot e tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhje dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të Shoqatës. Vlerësimi vijues është bërë sipas modelit të koston dhe AAM-të paraqiten në bilanc në vlerën neto (minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e mundshme nga zhvlerësimi, nëse ka). Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes.

Normat e amortizimit dhe metoda sipas grupeve:

	Norma e Amortizimit	Metoda e përdorur
Pajisje informatike	25%	Vlera e mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Vlera e mbetur
AAM të tjera	20%	Vlera e mbetur

IV. Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqatë jo fitimprurëse dhe, si e tillë, është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe taksave vendore.

4. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari rrjedhëse në Lekë	2,611,788	3,743,272
Llogari rrjedhëse në Euro	1,099,006	1,892,238
Para në arkë	41,807	14,178
Gjithsej	3,752,601	5,649,688

5. Kontribute të arkëtueshme

Kontributet e arkëtueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Te arkëtueshme prej anëtarëve	937,315	288,990
Gjithsej	937,315	288,990

6. Shpenzime të parapaguara

Shpenzime të parapaguar përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Garanci qira	280,160	280,160
Parapagime	203,000	-
Gjithsej	483,160	280,160

7. Aktivet Materiale Afatgjata

Aktivet e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	Mobilje / Orendi	Pajisje Kompjuterike	Gjithsej
Kosto			
Në 31 Dhjetor 2020	2,060,691	1,968,673	4,029,364
Shtesat gjatë vitit 2021	-	102,698	102,698
Pakësimi gjatë vitit 2021	(141,502)	(779,616)	(921,118)
Në 31 Dhjetor 2021	1,919,189	1,291,755	3,210,944
Amortizimi i Akumuluar			
Në 31 Dhjetor 2020	1,751,213	1,534,877	3,286,090
Amortizimi gjatë vitit 2021	37,895	112,773	150,668
Pakësimi gjatë vitit 2021	(133,101)	(750,575)	(883,676)
Në 31 Dhjetor 2021	1,656,007	897,075	2,553,082
Vlera Neto			
Në 31 Dhjetor 2020	309,478	433,796	743,274
Në 31 Dhjetor 2021	263,182	394,680	657,862

Shoqata Shqiptare e Bankave
Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2021

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga sa vijon:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Tatimi mbi të ardhurat personale	416,017	371,973
Kontributet e Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	246,534	216,641
Te pagueshme per personelin	2,148	-
Furnitorë	12,000	125,571
Tatim në Burim	-	14,749
Gjithsej	676,699	728,934

9. Aktivet Neto

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të AAB në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Ndryshimi në aktivet neto, paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, artikullohet në aktivet neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Aktivt neto përdoren në periudhat vijuese vetëm për objektivat e përcaktuara në statutin e ABB.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Balanca e mbartur në fillim të periudhës	6,233,179	7,699,038
Rritje/(Ulje) në aktivet neto	(1,078,940)	(1,465,860)
Balanca e mbartur në vitin e ardhshëm	5,154,239	6,233,178

10. Të ardhurat

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Tarifa anëtarësimi nga bankat anëtare	24,378,915	23,239,500
Sponsorizime nga bankat	4,777,493	4,303,950
Të ardhura nga trajnime për bankat anëtare	3,651,623	1,982,878
Gjithsej	32,808,031	29,526,328

Shoqata Shqiptare e Bankave
Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2021

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

11. Shpenzime organizimi për aktivitete

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Trajnime për bankat anëtare	7,560,845	6,322,222
Evente dhe Workshop	2,665,984	1,024,884
Anëtarësime	1,045,130	1,044,310
Gjithsej	11,271,959	8,391,416

12. Shpenzime promovimi dhe publikime

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Publikime	3,155,310	3,306,710
Materiale informative dhe publicitet	51,600	85,316
Gjithsej	3,206,910	3,392,026

13. Shpenzimet të përgjithshme dhe të administrimit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Paga personeli	12,054,391	11,753,997
Qira	2,943,100	2,971,440
Kontribute për sigurime	1,389,301	1,247,582
Shpenzime komunikimi	1,236,068	1,145,130
Shpenzime konsulence	540,000	880,090
Shpenzime të tjera	358,112	344,427
Kancelari dhe të tjera të konsumueshme	219,069	288,395
Sigurim shëndeti	184,605	186,225
Shpenzime utilitare	133,940	138,600
Shpenzime pastrimi	12,000	-
Shërbime përkthimi	44,731	36,222
Komisione bankare	29,575	21,267
Taksa lokale	15,000	15,000
Abonime	12,007	14,175
Noterizime	41,600	560
Gjithsej	19,213,499	19,043,111

Në muajin shtator 2021, 4 (katër) punonjës kanë nënshkruar Kontratë Individuale për anëtarësimin në fondin e pensionit vullnetar "Sigal". Sipas këtyre kontratave, punonjësve u lind detyrimi për të paguar kuotën mujore të kontributit në këtë skemë. Është dakordësuar që kuota të mbahet nga paga e tyre dhe të derdhet në llogarinë bankare të shoqërisë "Sigal Uniqa Group Austria" nga Shoqata Shqiptare e Bankave.

14. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara

Çështje ligjore

Më 31 dhjetor 2021, nuk ka çështje gjyqësore të ngritura kundër Organizatës apo nga Organizata.

Angazhime për qera

Organizata ka angazhime për kontratën e qerasë për ambientet për zhvillimin e akviteve për periudhën maksimumi deri në një vit 1.

15. Transaksione me palët e lidhura

Organizata ka pasur transaksione me palët e lidhura përgjatë rrjedhës normale të biznesit. Transaksionet kryesore janë ato të lidhura me fondet e marra nga Bankat.

16. Ngjarjet pas datës së raportimit

Drejtimi i Organizatës nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime apo shpjegime shtesë në këto pasqyra financiare.



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE